



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-015

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala ankuese M.G., kundër vendimit të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, A.B., më 27.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e pa lejuar, ankesa e palës ankuese M.G., e paraqitur kundër vendimit AD/GJTHPE.nr.14/24, i datës 20.12.2024, të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë.

A r s y e t i m

Në këtë Gjykatë më 31 dhjetor 2024, është pranuar ankesa e palës M.G., e parashtruar kundër vendimit AD/GJTHPE.nr.14/24, i datës 20.12.2024, të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë – A.B., me të cilin është refuzuar ankesa e palës së lartcekur për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B.S., me pretendimin se kryetari ka mbrojtur gjyqtarin dhe se për këtë arsye kishte humbur pronën që ka qenë objekt kontesti në gjykatë.

Kryetari i Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të cilat i janë bashkangjitur ankesës, vlerëson se:

- **Ankesa nuk është e lejuar.**

Nga shkresat e çështjes rezulton se parashtruesi ka ushtruar ankesë ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë B.Sh., duke kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij. Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, si Autoritet Kompetent për të vendosur lidhur me ankesën, konform dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar. 1.1 të Ligjit Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka vendosur përkitazi me ankesën e palës, me vendimin

AD/GJTHPE.nr.14/24, i datës 20.12.2024, ku e ka refuzuar atë si të pabazuar, nën arsyetimin se Kryetari i Gjykatës nuk mund të ndërhyj në punën e gjyqtarit me rastin e marrjes së vendimit, pasi që ky i fundit me rastin e marrjes së vendimit është objektiv dhe i paanshëm dhe se për shkelje të mundshme të karakterit procedural të cilat mund të trajtohen si pretendime ankimore, subjekt i vlerësimit janë gjykatat e shkallëve më të larta.

Ndaj vendimit të lartcekur në këtë gjykatë ka ushtruar ankesë pala M.G., me pretendimet e tij se me paraqitjen e ankesës së tij ndaj gjyqtarit B.Sh., kryetari i gjykatës nuk ka marr masa dhe se e ka mbrojtur gjyqtarin, duke humbur kështu pronën që ka qenë objekt kontesti. Prandaj, nga kjo gjykatë, ka kërkuar që Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, A.B., t'i shqiptohet sanksioni disiplinor në pajtim me ligjin.

Duke pas parasysh këtë gjendje të çështjes vlerësoj se ankesa në rastin konkret nuk është e lejuar për këto arsye:

Sipas Ligjit nr.06/L-057 “Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” respektivisht nenit 9 par.1 të këtij ligji - secili person fizik dhe juridik mund të parashtror ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo tek Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën ta përcjell tek Autoriteti Kompetent. Po ashtu, sipas këtij ligji - nenit 9 par.6 të tij autoriteti kompetent shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 par.2 (e fillon procedurën disiplinore kur vlerëson se ka bazë), përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Kurse, edhe sipas Rregullores (05/2019) nenit 7 par.1 të kësaj Rregulloreje pas ndërmarrjes së veprimeve fillestare, Autoriteti Kompetent ankesën mund ta hudh, refuzon, ose të kërkojë nga Këshilli fillimin e hetimeve. Mirëpo, me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet se në rastet kur autoriteti kompetent e refuzon ankesën për inicim të procedurës disiplinore ankuesi mund të ushtroj në ankesë ndaj këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj vendimit të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë së bashku me shkresat e bashkëngjitura, vlerësoj se ankesa është e palejuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë.
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.